

Probleme të vlerësimit të njohurive të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe dhe të formimit gjuhësor të nxënësve.

Çështjet:

1. Matja, kontrolli i njohurive. Çfarë duhet të vlerësojmë.
2. Përse duhet të vlerësojmë.
3. Vlerësimi i nxënësve.
4. Fusha e njohjes. Taksionomia e Blumit.
5. Testet, llojet, ndërtimi i tyre.

1. Matja, kontrolli i njohurive. Çfarë duhet të vlerësojmë.

Mësuesi duhet të vlerësojë gjithnjë pozicionin e tij. Kështu ai gjithnjë duhet të pyesë veten: **Ku jemi tani? Ku po shkojmë? Ç'rrugë do të ndjekim? Ç'mjete duhet të kemi në dispozicion? Kur dhe ku duhet të arrijmë?** Këto dhe të tjera pyetje duhet të shqetësojnë dhe të ushqejnë mësuesin në punën e përditshme me nxënësit.

Ky vlerësim dhe rivlerësim i situatës për të mësuarit dhe të nxënësve përbën kontrollin e njohurive. Pikërisht kontrolli bën të mundur verifikimin e rezultateve dhe aftësitë e tij intelektuale. Objektivat mësimore mund të ndahen në tri fusha kryesore, në bazë të fokusit të tyre parësor:

Fusha e njohjes (kognitive) përfshin ata objektiva që lidhen me përvetësimin e njohurive dhe me zhvillimin e aftësisë dhe të zotësisë intelektuale. Zhvillimi i shoqërisë teknologjike, moderne, duke i dhënë përparësi shkollës, ka nevojë për njerëz me dije bashkëkohore që të hulumtojnë informacione, të analizojnë probleme, të krijojnë e të japin vlera. Këto mikroaftësi përfshihen brenda taksionomisë së Blumit.

Fusha e dytë e rëndësishme është zhvillimi i pikëpamjeve dhe të vlerave të nxënësve, pra **fusha emocionale (afektive)**.

Fokusi i tretë është **fusha psikomotorë** e cila përfshin zhvillimin e shkathtësive dhe të aftësive muskulore e lëvizore.

Në fund të një veprimtarie mësimore, lind nevoja që të maten në përputhje me objektivat didaktikë të përcaktuar nga vetë mësuesi apo nga hartuesit e programeve dhe të teksteve.

Matja është një përpjekje për të përshkruar në mënyrë sasiore rezultatet e nxënies. Çdo nxënës ka nevojë të dijë sa rezultativ apo i suksesshëm është në nxënie, krahasuar me të tjerët apo me objektivat e lëndës mësimore. Matja e rezultateve e cila realizohet me anë të kontrollit, shoqërohet gjithnjë me vlerësim.

Vlerësimi nënkupton vendosjen e vlerës një diçkaje. Ai është matje, domethënë përmban një përshkrim sasior e cilësor dhe më tepër një vlerë gjykimi. Kjo është cilësia që e bën të ndryshëm ngamatja.

Po përse duhet të vlerësojmë?

Së pari, vlerësimi shërben për të përcaktuar shkallën e përvetësimit të njohurive nga nxënësit dhe nivelin e realizimit të objektivave.

Së dyti, duhet të krijohet një “besim” tek bashkësia: prindërit, institucionet publike dhe qeveritare për përdorimin me vend të burimeve (njerëzore, materiale, dhe financiare). Sistemet arsimore duhet të justifikojnë këto burime që u janë vënë në dispozicion.

Së treti, kontribuon për të përmirësuar menaxhimin e arsimit, në nivele të ndryshme. Menaxhimi është një potencial që rrit eficiencën e arsimit.

Së katërti, vlerësimi mund dhe duhet të çojë në përdorimin e metodave më të përshtatshme të mësimdhënies.

Mënyra e vetme për të vlerësuar eficiencën e një sistemi arsimor është vendosja e “treguesve arsimorë të matshëm objektivisht”. Në këtë rast përdoren disa kategori themelore treguesish që lidhen me nxënësit, mësuesit, të dhënat për kurrikulat në përgjithësi dhe për tekstet a programet në veçanti, përparimin e nxënësve, përcaktimin e strategjive në arsim në arsim, koston etj.

Vlerësimi i kurrikulit- Me termin “kurrikulum” kuptojmë dokumentacionin shkollor, planet, programet, tekstet e literaturën përkatëse, si dhe të gjitha aktivitetet e përbashkëta të mësuesit dhe të nxënësit në zbatimin e këtij dokumentacioni për dhënien, përpunimin dhe kontrollin e njohurive. Se çfarë mësojnë nxënësit varet nga ajo çfarë japin dhe si japin mësim mësuesit e këto të fundit varen nga standartet kombëtare, dokumentet shkollorë, mjeshtria në mësimdhënie. Shumë prej këtyre faktorëve janë të pavarur nga shkolla.

Vlerësimi i shkollave, niveli i mësuesve dhe i drejtuesve

Për të njohur dhe për të përsosur sistemin arsimor është thelbësore të vlerësohen shkollat në të gjitha drejtimit e tyre. Vlerësimi i punës së nxënësve përdoret shpesh për të gjykuar cilësinë e shkollës. Por do të ishte e padrejtë dhe e papërshtatshme të vlerësosh shkollën vetëm në bazë të rezultateve të nxënësve.

Sot vlerësimi i shkollës duhet të synojë në të gjithë komponentët e punës së saj vepruese, si në drejtim të organizimit, administrimit dhe në atë të drejtimit. Në shkollë zakonisht përdoren dy lloje vlerësimesh: i jashtëm dhe i brendshëm. Për të mos i lënë rrugë spontanitetit në këtë fushë, duhet që të vendosen disa parametra. Në praktikën e shumë shkollave evropiane, drejtuesit vëzhgojnë dhe ndihmojnë, duke u mbështetur në dy boshte themelore: niveli metodiko-shkencor i mësuesit dhe niveli i përvetësimit të njohurive nga nxënësit.

Po japim një model.

1. Niveli shkencor dhe metodik i mësuesve

20 pikë

1.1. Gjetje e ekuivalentit didaktik të përshtatshëm për arritjen e një zbërthimi me nivel të lartë shkencor të temës së re 5 pikë

1.2. Trajtimi i lëndës duke parashtruar fakte e dokumente të ndryshme shkencore

5 pikë

1.3 Rigorozitet shkencor në testet dhe kërkesat e tjera ndaj nxënësve

4 pikë

1.4 Nxitje e interesave shkencore në orën e mësimi

2 pikë

1.5 Përdor metoda aktive që nxisin mendimin e punën e pavarur

4 pikë

2. Niveli i përvetësimit të njohurive nga nxënësit

30 pikë

2.1 Saktësia e përgjigjeve të nxënësve	8 pikë
2.2 Niveli teorik i tyre	4 pikë
2.3 Aftësia argumentuese dhe praktike e nxënësve	4 pikë
2.4 Aftësia për të punuar në mënyrë të pavarur	5 pikë
2.5 Aftësia për të punuar në situatë të reja	5 pikë
2.6 Niveli i zgjidhjes së detyrave të shtëpisë	4 pikë

3. Vlerësimi i nxënësve.

Baza tradicionale e vlerësimit të nxënësve është sfera psikomotorike dhe e bazuar në teoritë psikologjike të bihejvioristëve të shek. XX. Vlerësimi i nxënësve është një detyrë mjaft komplekse dhe me përgjithësi dhe shërben për qëllime të ndryshme. Për këtë arsye, në literaturën bashkëkohore e gjejmë të përcaktuar në trajta të ndryshme, si një mënyrë për të diagnostikuar pikat e forta dhe dobësitë e nxënësve dhe të ndihmojnë në procesin e të mësuarit. Janë dhënë këto përkufizime: ***“Vlerësimi i nxënësve është një epatë kyçe në ciklin e mësimdhënies dhe të nxënies”*** ose ***“Vlerësimi i nxënësve është si një dritare nëpërmjet së cilës shoqëria sheh se Ç'bëhet në arsim, komunikimi bëhet nëpërmjet kësaj dritareje”***.

Nëpërmjet kontrollit mësuesi realizon matjen dhe vlerësimin e njohurive. Roli i tij në procesin e të mësuarit dhe të nxënësve është sepse:

- U jep nxënësve informacionin që i nevojitet për të ditur se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe çfarë duhet të bëjnë më tej
- I ndihmon ata të kuptojnë nxënësit, aftësitë, nevojat e tyre
- U jep nxënësve informacionin që u nevojitet për të përfutur nga suksesi dhe pasaktësitë apo dëshirat e tyre
- Është i rëndësishëm për motivimin e nxënësve

Vlerësimi bashkëkohor i nxënësve kërkon të vërë në dukje aftësitë e çdo individi. Çdo nxënës jep diçka, nuk ka fëmijë që të mos bëjë gjë, për këtë arsye vlerësimi duhet të nxitë anët pozitive të të mësuarit.

Kontrolli i njohurive është sistematik dhe bëhet me gojë e me shkrim (njëri nga llojet është edhe testimi) në mësimdhënie është tri llojesh dhe i përgjigjet qëllimeve të caktuara:

- **Testim për të vlerësuar nivelin fillestar** të njohurive që zotërojnë nxënësit në fillim të një lënde apo kursi studimi. P.sh. në fillimin e ciklit fillor. Mbë këtë bazë ndërtohet puna e mëtejshme, madje edhe për t'i ndarë në nivele, për të organizuar punën e diferencuar. - Test fillestar mund të bëhet edhe kur kalohet nga një klasë në tjetrën.

- **Testim gjatë mësimdhënies**-që quhen edhe teste formuese. Synojnë të shohin progresin e nxënësve, çfarë kanë përvetësuar apo jo, ku duhen ndihmuar nxënës që kanë probleme dhe planifikohet puna për të eliminuar mangësitë. Të dyja këto lloje testesh quhen diagnostikuese.

- **Testim në përfundim të mësimdhënies.** Për të bërë vlerësimin përfundimtar të disa temave, të kapitujve apo në përfundim të një kursi të caktuar, ky quhet test përmbljedhës. Njëkohësisht ai shërben edhe si tregues i efektshmërisë së mësimdhënies.

Për ta bërë më të qartë rëndësinë e vlerësimit sistematik, po paraqesim në mënyrë sistematike një model mësimdhënieje që siguron vlerësimin e nxënësve

PËRGATITJE E OBJEKTIVAVE MËSIMORE

VLERËSIM FILLESTAR I NJOHURIVE TË NXËNËSVE

MËSIMDHËNIA

1. Vëzhgim i procesit të të nxënës
2. Diagnostikim i vështirësive të të nxënës

VLERËSIM I PËRFUNDIMEVE TË PARASHIKUARA

Përmirësimi i të nxënës dhe mësimdhënies	Nxjerrja dhe përpunimi i rezultateve e komunikimi i tyre, nxënësve, prindërve	Përdorimi i rezultateve për qëllime të tjera shkollore
---	--	---

3. Fusha e njohjes: Taksinomia e Blumit

Në testet për matjen e njohurive të nxënësve, përqendrimi bëhet në objektivat e sferës së njohjes, e cila ka të bëjë me nivelin shkencor të njohurive dhe realizimi i tyre pasqyrohet nëpërmjet kujtesës dhe operacioneve të ndryshme të të menduarit. Blumi i klasifikoi objektivat e sferës njohëse në 6 nivele, që tashmë quhet taksinomia e Blumit. Ato janë:

Tri nivele për mësuesit	Nivelet e Blumit	Foljet përshkruese
Niveli i parë (i ulët)	1. Të njohurit Është riprodhimi i një fakti, pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritjet e emrave, rregullave dhe përkufizimeve dhe e shpjegimeve ashtu siç janë dhënë.	Përkufizo, përshkruaj me fjalë e tekstit, vër në tabelë, harto një listë, emërto, riprodho...

	Është niveli më i ulët i rezultateve në fushën e njohjes	
	2. Të kuptuarit Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes.	Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, perifrazo, rishkruaj, përgjithëso, interpretoje ndryshe...
Niveli i dytë (mesatar)	3. Aplikimi Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, koncepte, ligje dhe teori.	Ndrysho, provo, vër në dukje, përgatit, prodho, lidh, trego, shpjego përdor...
	4. Analiza Është aftësia për të copëtuar materialin në pjesë përbërëse, çka sjell kuptim më të mirë të organizimit të tij. Dhe, meqë krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma e materialit, niveli është më i lartë se të kuptuarit.	Ndaj në pjesë, shpjego përse, diferenc, vër në dukje, lidh, seleksiono...
Niveli i tretë (i lartë)	5. Sinteza Është aftësia për të formuar një të tërë duke bashkuar pjesët. Mund të jetë: kombinim i ri plani veprimesh, klasifikim.	Kombino, hart, krijo, zgjidh, kompoz, jep mendime, përmirëso, risistemo, rindërto, rishiko, planifiko...
	6. Vlerësimi Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali e një ideje, vlerësimi i zgjidhjeve të problemit.	Krahaso, përfundo, kritiko, përshkruaj, shpjego, justifiko, interpreto, përmbledh dhe përgjithëso...

Në zbatimin e taksinomisë së Blumit duhet të ruheni nga dy praktika ekstreme, më të përhapura në mësim, të cilat janë:

1. Për shkak të informacionit të madh ose kualifikimit të pamjaftueshëm në mësim, mbizotërojnë vetëm detyra dhe kërkesa të nivelit të parë. Kjo dëmton zhvillimin logjik të nxënësve, çon në riprodhim mekanik dhe në fund të programit a pas mbarimit të shkollës, nxënësit e shumë "i recitojnë" gjërat, por nuk janë në gjendje të kryejnë operacine mendore.
2. Praktika e dytë ekstreme është kur mësuesi kalon në nivele të larta, pa u bindur se të gjithë nxënësit i kanë fituar aftësitë e nivelit të parë. Kjo e bën mësimin të pakuptueshëm për shumë nxënës, ul motivimin e tyre dhe akuzon padrejtësisht shumë nxënës për prapambetje intelektuale. Të dy ekstremet nuk këshillohen.

5. Testet, llojet, ndërtimi i tyre.

Siç kemi theksuar edhe më parë, njohja me vendin dhe rolin e vlerësimit, si pjesë përbërëse e procesit mësimor-edukativ, ka rëndësi të veçantë për të siguruar një përvetësim të qëndrueshëm të dijeve dhe për të siguruar efektivitet të lartë të këtij procesi. Një teknikë dhe rrugë e efektshme mjaft e përdorshme vitet e fundit është testimi.

Fjala “test” vjen prej foljes latine “testor, testari” që do të thotë “për të dëshmuar”, “për të argumentuar”. Mësuesit, para se të realizojnë testin, duhet të udhëhiqen nga ide dhe koncepte që lidhen me qëllimin, synimin dhe punën përgatitore. Kështu, konkretisht, ata duhet të pyesin veten:

1. Pse testojmë?

Kjo, padyshim, lidhet ngushtë me qëllimet për të cilin e realizojmë atë, me objektivat e tij. Qëllimi i testit, ashtu si edhe i vlerësimit në përgjithësi mund të jetë:

- për të përcaktuar zotësitë e nxënësve në përgjithësi apo për disa aftësi të veçanta;
- për të diagnostikuar vështirësitë
- për të krahasuar rezultatet e mëparshme;
- për të vlerësuar dhe për të vlerësuar metodat e mësimdhënies, për të parë vlerat e frytet e dokumentacionit shkollor, për të motivuar nxënësit etj.

Sigurisht, duhet kuptuar se një test i vetëm nuk mund të zgjidhë a të realizojë të gjitha këto qëllime, por një ose disa prej tyre.

2. Çfarë duhet të vlerësojmë?

Mësuesi ose specialisti duhet të përcaktojë qartë se çfarë njohurish a qëndrimesh do të vlerësojë, të lidhura këtu me kapitullin apo me grup-temat a temë të veçantë, raportin e njohurive teorike me ato praktike etj.

3. Ç’punë kemi bërë a duhet të bëjmë për të përgatitur nxënësit?

Mësuesit duhet të punojnë me synime të qarta, jo vetëm në kohët para realizimit të testit të fundit, por edhe gjatë gjithë vitit të drejtojë dhe të aftësojë nxënësit e tij, me qëllim që t’i familjarizojmë ata me një formë të tillë kontrolli. Testet, pa dyshim, duhet të jenë gjithnjë pasqyrim i përmbajtjes së temave dhe të materialit mësimor të zhvilluar. Për rrjedhim, vlerësimet përmbledhëse të testeve na ndihmojnë për një mësimdhënie efektive. Këto që thamë më sipër, na detyrojnë që para zhvillimit të testit të mendojmë për këto gjëra:

- ***përcaktimin e qartë të objektivave të testit;***
- ***përcaktimin e llojit të testit;***
- ***gjatësinë e testit;***
- ***njohuritë dhe shprehitë praktike që do të kontrollohen;***
- ***ç’shcallë vështirësie do të ketë, për ç’nivel do të jetë, a ka material për të gjitha nivele;***
- ***nëse është i kombinuar, cili do të jetë raporti ndërmjet llojeve etj.***

Gjykimi i problemit në këtë mënyrë, largon dilentantizmin, rrit vlerëshmërinë e testit, forcon besueshmërinë dhe objektivitetin e tij.

Tipat më të zakonshëm të testeve në sferën njohëse, klasifikohen në dy grupe:

Teste subjektive ose ese

Teste objektive

Në grupin e parë hyn ai lloj testi që kërkon përgjigje origjinale nga nxënësit, natyrisht, në lidhje me përvojën e fituar gjatë shkollimit dhe më gjerë ku, krahas njohurive, shprehive, nxënësi shpreh mendimet, ndjenjat, emocionet dhe qëndrimet personale. Në tekstet dhe në programet në zbatim, në rubrikën gjuhë e folur dhe gjuhë e shkruar, ku nxënësit vihen në situata dhe pozita praktike për të shprehur mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim, ka mundësi të mësha për të aplikuar teste të tilla.

Në testet objektive hyjnë disa lloje testesh të cilat kanë si qëllim kryesor për të përcaktuar, matur e për të vlerësuar nivelin e njohurive, shakathësive dhe të shprehive, për të analizuar, për të ballafaquar dhe për të interpretuar faktet. Ndërsa, për testin subjektiv, kërkohet pak kohë për ta hartuar dhe shumë kohë për ta korrigjuar, për testet që hyjnë në grupin e dytë, është e kundërt. Për të hartuar një test objektiv, duhet të kemi parasysh disa kritere, si:

- *Të përcaktohen qartë objektivat e testit, kapitullin, temat, grup-temat;*
- *Të përdoret gjuhë e saktë dhe e qartë*
- *Të mënjanohet dhënia e informacionit që lejon hamendjen për gjetjen e përgjigjeve të mundshme;*
- *të kërkohen gjëra thelbësore dhe të gjëra të parëndësishme;*
- *të përshtaten vështirësitë e testit me nivelin e nxënëseve;*
- *të krijohet mundësi pune për të gjithë;*
- *të parapërgatitet një sistem vlerësimi*

Po japim disa lloje testesh objektive, shoqëruar me sqarime të shkurtra dhe shembuj

Me përgjigje të shkurtra: Karakterizohen me lënia e disa vendeve bosh, ku nxënësi duhet të shkruajë si përgjigje një fjalë, fjali, frazë, simbol etj. Është mjaft efikas në testimin e njohurive, por nuk kërkon interpretim dhe përgjithësim p.sh.

Plotëso etiketën bosh: "Dje ::::::::::: mora syzet tek mjeku"

- A. ne
- B. ti
- C. ai
- D. unë

Pyetjet me përgjigje PO ose JO. Në këtë tip jepet vetëm një rast dhe kërkohet nga nxënësit të tregojnë nëse është i vërtetë apo i rremë p.sh.

Është shkruar saktë:

- A. Drita, shoqja ime
- B. drita e hënës
- C. drita, shoqja ime
- D. Drita e hënës

Ose:

Në fjalinë e mëposhtme: **”Degët e pemës u mbushën plot me zogj të vegjël”**, është grup emëror:

- A. u mbushën plot
- B. degët e pemës
- C. me zogj të vegjël
- D. dy të fundit

Ose:

Janë miemra të nyjshëm:

- A. Lumë i madh
- B. Fusha pjellore
- C. Libër i bukur
- D. Djalë punëtor

Test me përputhje a kombinim: veçori e tij është prania e dy kolonave me fjalë a fjali ku krahas pyetjes a fjalisë është edhe përgjigja, jo drejtpërdrejtë por me alternim p.sh.mund të lidhen titujt e veprave me emrat e autorëve, shkaku me pasojën, parimet me konceptet etj. P.sh. Bashkoni me një vijë temat e dy kolonave për të krijuar fjalë të përbërë

-atdhe	qepës
-rroba	i bardhë
-zemër	i ëmbël
-hekur	udhë
-zë	dashuri
-vajguri	sjellës

Kur përdoret ky lloj testi, këshillohet që të mos jepen më shumë se 10-12 elemente, por jo më pak se 5. Njëra kolonë mund të ketë më shumë elemente.

Test interpretues. Quhet ai lloj testi që kërkon një mendim të motivuar të nxënësit, mbi bazën e njohurive dhe të shprehive që ka përvetësuar nxënësi gjatë një kapitulli. Përgjigja duhet të jepet e krahasuar me koncepte të tjera, pasi ofrohet një informacion i shkurtër dhe i qartë. P.sh.

Fjala e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme: **”Sulejmani shikoi mirë brenda kasolles”** është:

- A. kryefjalë
 - B. folje
 - C. rrethanor mënyre
 - D. rrethanor vendi
- Argumentoni përgjigjen tuaj.

Test me zgjedhje: Aktualisht është lloji i testit më i përdorur. Kërkon shumë kohë për t’u hartuar, por korrigjohet shpejt. Nxënësi punn në fletët që i jep mësuesi.ndërtohet duke dhënë një pyetje a pohim, shoqëruar me 3-5 alternativa, nga të cilat njëra është e saktë. P.sh.

Cili emër është shkruar gabim:

- A. Shqipëria

- B. porosia
- C. kajsija
- D. çatia

Ose:

S'është emër i gjinisë femërore:

- A. fletë
- B. dritë
- C. gjuhë
- D. fik

Ose:

Është emër i trajtës së shquar:

- A. postier
- B. gjethe
- C. tavolina
- D. fletore

Akordimi i pikëve

Akordimi i pikëve,për përgjigjet e sakta të pyetjeve të një testi, është momenti më i rëndësishëm dhe me mjaft pëtgjegjësi.

Sigurimi i një pikëzimi të përshtatshëm për lloje të ndryshme të pyetjeve, bën të mundur që të zvogëlohet ne minimum subjektiviteti në vlerësimin e nxënësve dhe krijon mundësinë e krahasimit të dijeve të nxënësve.

Ektostojnë shumë sisteme pikëzimi , por sistemi që përdoret sot më shumë është ai analitik.

Dy elementet bazë të këtij sistemi janë: caktimi i pikëve për çështjen që testohet dhe skema e pikëzimit. Në skemën e pikëzimit jepen kritwret e shpërndarjes së pikëve, që janë akorduar për çështjen që do të testohet, duke pasur për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje. Pikëzimi i pyetjeve “ese” është më i vështirë dhe mbart në vetvete rrezikun e subjektivizmit. Ky rrezi vjen se në përgjigjen e pyetjeve ese nuk ka kufij të prerë, të dukshëm mes asj që pr përgjigjen knsiderohet e derjtë, e saktë dhe asaj që konsiderohet e gabuar, e pasaktë. Përgjithësisht përcaktimi i këtij kufirë bëhet nga personi që akordon pikët.

Sa më afër objektivitetit të përgjigjes së saktë të jetë përgjigjja e nxënësit, aq më shumë pikë fiton ai dhe në të kundërtëfiton pak pikë.

Pikëzimi i pikëve bëhet sipas qëllimit të testimit. Kështu, nëse testimi bëhet për të testuar njohuritë, që nxënësi ka për përmbajtjen e një lënde për një ose disa tema, akorduesi i pikëve i jep këtij aspekti më shumë pikë, në krahasim me dy aspektet e tjera.

Kur qëëlimi i testimit është testimi i logjikës së përgjigjes së nxënësit, atëherë akorduesi i pikëve i jep vlerësimin të këtij aspekti më shumë pikë në krahasim me dy aspekte të tjera.

Pasi përcaktohet se sa pikë kanë fituar në një test nxënësit, duhet që pikët e fitura prej tyre t'i konvertojnë në nota.

Sipas kësaj teknike, pasi përcaktohet përqindja e pikëve, q do të shërbejë si kufi i poshtëm i mjaftueshëm për kaimin e nxënësve, caktohen intervale t e pikëve që duhet të marrin nxënësit për secilën prej notave 4-10, p.sh.

<u>Nota</u>	<u>% Pikëve</u>
4	0-24
5	25-38
6	39-51
7	52-64
8	65-77
9	78-99
10	91-100